

**RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT
TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER AKTIVITETIN
“FONDERI PER PRODHIMIN E MATERIALEVE TE
GIZES”**

**PER SHOQERINE “ENIRA - METAL” SHPK
ISH-KOMBINATI METALURGJIKNJESIA ADMINISTRATIVE
BRADASHESH, BASHKIA ELBASAN**

Studimi përfshihet në Shtojcën I, Pika 2.4.Fonderite e metaleve ferroze



Subjekti Studio “Elbasani”

Shoqëria : “ENIRA- METAL” SH.P.K.

Eksperte Mjedisore

Bashkia ElbasanIng. Lila Karaj

1.2 Raporti paraprak i VNM.....

- a.**Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi.....
- b.**Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij.....
- c.**Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundëshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër.....
- ç.**Një përshkrim për shkarkimet e mundëshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe përdorimi i mbetjeve. Shkarkimet e mundëshme në mjedis si ujëra të ndotur, gazra, pluhra, zhurma, vibrime, prodhimi i mbetjeve.....
- d.** Informacion për kohëzgjatjen e mundëshme të ndikimeve negative të identifikuara për aktivitetin “Fonderi për Prodhimin e Materialeve prej Gize”, Bashkia Elbasan.....
- dh.** Të dhëna për shtrirjen e mundshmehapsinore të ndikimeve negative në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të.....
- e.** Mundësitë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin...
- ë.**Masat e mundëshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis.....
- f.** Ndikimet e mundëshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).....

2. Raporti paraprak i VNM

Raporti i VNM për shfrytëzimin e godinës dhe kryerjen e procesit teknologjik për aktivitetin “Fonderi për Prodhimin e Materialeve të Gizës”ka për qëllim të shërbejë:

- Si instrument për mbrojtjen e mjedisit në të cilin realizohet aktiviteti prodhues
- Në fuqizimin e komunitetit të zonës për veprime të mbrojtjes së mjedisit
- Në kontrollin e përdorimit të qëndrueshem të burimeve natyrore të zonës ku prodhohen materialet e gizës.

Qëllimi për të cilin vlerësohet ndikimi është që veprimtaria që ushtrohet për “aktivitetin “Fonderi për Prodhimin e Materialeve të Gizës”” në Njësinë Administrative Bradashesh, të vlerësohet në mënyrë objektive si dhe të propozohen masat më efikase për minimizimin e ndikimeve thelbësore.

Në përputhje me kërkesat e Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe akteve nënligjore përkatëse, **objektivat** për realizimin e funksionit të kësaj veprimtariekonsistojnë në:

- Identifikimin e ndikimeve në mjedisin që shoqëron aktivitetin prodhues të materialeve të gizës, gjatë gjithë periudhës së funksionimit të objektit të Fonderisë.
- Analizën e faktorëve lokalë negative dhe pozitive mjedisore dhe përmirësimin e vlerave ekologjike të terrenit ku është vendoset godina industrial e Fonderisë së Gizës.
- Përcaktimi i masave zbutëse, për secilin nga aktivitetet prodhuese që do të kryhet në “Fonderinë për Prodhimin e Materialeve të Gizës””
- Analiza Mjedisore shërben për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet mjedisore potenciale të ardhshme që shoqërojnë projektin. Masat zbutëse të përshtatshme do të përfshihen në dokumentet e zbatimit të teknologjisë prodhuese dhe shfrytëzimit të objektit industrial për të ardhmen.

Studimi i vlerësimit të ndikimit në mjedis për aktivitetin “Fonderi për Prodhimin e Materialeve të Gizës” Njësia Administrative Bradashesh, është udhëhequr nga orientimet e mëposhtme:

- Rëndësia e funksionimit të plotë të objektit për prodhime industriale dhe teknologjive prodhuese me standarte bashkëkohore.
- Kërkesat dhe nevojat e investitorit për **rritjen e aktivitetit të prodhimit industrial.**
- Në identifikimin e ndikimeve negative dhe lokale
- Në marrjen e masave zbutëse duke patur parasysh ndërhyrjen në zonë me aktivitetin “Fonderi për Prodhimin e Materialeve të Gizës””, interesave ekonomike sociale dhe kulturore të investimit në fushën e industrisë së rëndë.
- **Në masat orientuese për një zhvillim të qëndrueshëm të mjedisit në Bashkinë Elbasan**

Ky raport paraprak identifikon ndikimet lokale negative dhe pozitive në mjediset humane dhe është marrë parasysh vlerësimi i rrezikut të funksionit të Fonderisë së prodhimit të Gizës që do të

funksionojë në zonën industriale të ish Kombinatit Metalurgjik. Reduktimi i ndikimeve negative është ndërthurur me ndikime të rëndësishme lokale dhe strukturore në këto faza kryesore:

- Hartimi i objektivave orientuese në raportin e VNM.
- Grumbullimi dhe përpunimi i materialeve bazë egzistuese, plotësimi i formularëve përkatës për këtë raport, seleksionimi i tyre për përdorim. Verifikimi në terren i të dhënave egzistuese dhe mbledhja e të dhënave të mundëshme biofizike dhe humane për të bërë analizën e fakteve për procesin e “Fonderisë për Prodhimin e Materialeve të Gizës”.
- Hartimi i VNM dhe depozitimi i saj në Bashkinë Elbasan si dhe porositësi i këtij materiali, bashkë me subjektet vendimarrëse dhe kontrolluese të aspekteve mjedisore në nivel lokal e qëndrore.

a. Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet projekti për aktivitetin “Fonderi për Prodhimin e Materialeve të Gizës”, Njësia Administrative Bradashesh, Bashkia Elbasan, shoqëruar dhe me fotografi

Flora dhe fauna. Aktiviteti në vlerësim është një instalim i cili prodhon në rrugë industriale prodhime të gizës. Objekti është brenda Kompleksit Metalurgjik i cili ka mbi 40 vjet që ushtron aktivitetin e tij prodhues në këtë rajon. Të tilla zhvillime kanë dhënë influencat e tyre në florën dhe faunën e zonës. Është tjetërsuar tërësisht sipërfaqja e truallit gjatë kësaj periudhe kështu që për zonën përreth nuk kemi zhvillime normale të florës dhe të faunës.

Foto Nr.01 Pamje ajrore e bimësisë në zonën e projektit



Bimësia natyrore përfaqësohet nga mbeturina të shkurreve mesdhetare, dushku apo shelgu. Në fushat rreth subjektit kultivohen drithërat e bukës: gruri, misri si dhe duhani e rushi. Është zonë e kultivimit të ullirit, fikut kumbullës. Në blegtori zona e Bradasheshit shquhet për rritjen e lopëve, të derrave, të imtave e shpendëve. Takohen mjaft zogj me banim të përhershëm por edhe shtegtarë të cilët popullojnë zonën duke përfshirë këtu edhe territorin e objektit ku prodhohen materialet e gizës. Në kafshët e egra kemi popullim të lepurit të egër, por jo rrallë takohet edhe dhelptra dhe në stinën e ftohtë, pjesa pranë bregut të lumit Shkumbin popullohet me shpezë të egra si rosa, ajza, shapka etj. Përsa i përket bimësisë së zonës jashtë konturit të sipërfaqes së

ushtrimit të aktivitetit ajo përbëhet kryesisht nga sipërfaqe publike dhe private të gjelbëruara. Bimësia që karakterizon këtë zonë, për rrethinat të cilat janë të banuara dhe të lira nga ndërtimet janë kulturat bujqësore dhe bimësia barishtore e pemëve të larta, por këto të fundit të rralla e jo në trajtë pyjesh e habitatesh. Kulturat bujqësore të zonës variojnë nga më të ndryshmet, duke përmendur drithërat, foragjeret, perimet, pemët frutore, agrumet, vreshtat e rrushit, ullinjët, etj. Bimësia e rajonit është kryesisht shkurre-barishtore dhe pjesërisht dru pyjorë në lartësitë e maleve e kodrave (edhe përgjatë kanaleve kulluese dhe në oborret e banesave dhe objekteve private). Ky aktivitet nuk prek zona pyjore, apo zona të mbrojtura me ligj. Nuk do të ketë ndërtim të ri dhe nuk do të zihet sipërfaqe e re toke.

Zona në studim nuk vlerësohet si zonë me status të veçantë nga kuadri ligjor për zonat e mbrojtura. Zona në vlerësim nuk përmban sipërfaqe të mbrojtura. Ajo ndodhet në distancë të largët nga ato siç tregohet edhe në hartën e Rajonit për Zonat e Mbrojtura.

Gjelbërimi i zonës ku kryhet aktiviteti industrial “Fonderi për Prodhimin e Materialeve të Gizës”, është një tjetër tregues i gjendjes mjedisore. Gjelbërimi dhe mirëmbajtja e sipërfaqes së gjelbërt në këtë njësi administrative kryhet aktualisht nga Bashkia Elbasan. Gjelbërimi në zonën e ndërtimit është ai privat me bimësi të ulët e pemë të mbjella në distancë dhe gjelbërimi i rrugëve të brendshme të kompleksit industrial.

Foto Nr. 02-03 Pamje e bimësisë së zonës në zonën e ish Kombinatit Metalurgjik Elbasan



Gërmimet arkeologjike.

Elbasani njihet si vend-banim i hershëm ilir, si rrjedhojë edhe objektet monumentale të këtij Rajoni janë të shumta. Njihen dhe janë të miratuara me ligj rreth 85 objekte, banesa, kala, qendra historike, si objekte me rëndësi arkeologjike të kategorisë së parë dhe të dytë. Ato ndodhen në distancë me zonën ku zhvillohet projekti.

b. Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij

Hidrologjia, ujrat sipërfaqësore dhe nëntoksorë. Përsa i përket hidrologjisë ajo është e shprehur në rajone me ujëra nëntokësore dhe ujëra sipërfaqësore. Ujërat sipërfaqësore janë ato të ujrave të shiut ose të larjes së sipërfaqes që zbresin poshtë në mënyrë natyrale. Ujërat nëntokësore nuk preken gjatë procesit të prodhimit të Materialeve të Gizës”. Për punonjësit që do të popullojnë objektin do të përdoret uji që furnizon Njësinë Administrative Bradashesh.

Kushtet Hidrogeologjike. Nga studimet e kryera në zonën e ish Kombinatit Metalurgjik në Elbasan (nga matjet e kryera në shpimet për disa vite në punimet e ndryshme që autorët kanë kryer në zonën e Elbasanit) rezulton se niveli i ujit nëntokësor në dimër dhe në verë është i ndryshëm. Autorët e këtij studimi kanë shfrytëzuar të gjitha punimet ekzistuese dhe punimet e reja në to që janë kryer matje në disa kohë gjatë gjithë periudhës së studimit dhe rezulton se në pjesën më të madhe të zonës niveli i ujit nëntokësor është afër sipërfaqes së tokës (-10.00-10.50m) nga sipërfaqja e tokës natyrore. Ky nivel i ujrave përfaqëson nivelin minimal të ujit nëntokësor. Nga matjet ekzistuese rezulton se niveli i ujit në dimër është -4.50m. Nga analizat e kryera rezulton se ujrata nëntokësorë janë neutralë, nuk janë agresive karshi hekurit dhe betonit.

Foto Nr. 04-05 Pamje të Lumit Shkumbin dhe pjesa e shtratit të Lumit në zonën Bradashesh



Fare pranë Ish Kombinatit Metalurgjik ku ndodhet objekti në studim, kalon Përroi i Kushës. Përroi i Kushës në një pjesë të tij kalon në një kanal betoni që funksion normalisht. Në dalje të Njësisë Administrative Bradashesh, ky përrua krijon gjithmonë probleme sepse del nga shtrati i tij, që është tepër i ngushtë dhe i ngarkuar me prurje. Shtresa ujëmbajtëse e depozitimeve të shkrufta aluviale në luginën e Shkumbinit ka përhapje nga fshati Labinot në lindje deri në Cërrik-Papër në perëndim me një gjatësi rreth 18 km. Gjerësia e shtresës ndryshon nga 1 km në 7 km e para në lindje të Krastës deri në 5 km në perëndim të Krastës dhe të qytetit të Elbasanit. Trashësia e shtresës është mbi 50 m në pjesën lindore, ndërsa në pjesën perëndimore është mbi 100m. Mendohet se potencia në pjesën perëndimore është 180 - 200m, ndërsa në lindje 80 – 100m. Vetëm në Krastën e Vogël, shtresa ujëmbajtëse e zhavoreve aluviale ka trashësi 10.3m. Kompleksi i karbonateve ka rezerva të kufizuara që shkarkohen në formë burimesh natyrore në zhavorret aluviale pranë strukturës së Krastës së Madhe dhe të Vogël.

Përshkrim i ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë në zonën e projektit.

Në zonën e zbatimit të këtij projekti ka burime ujore të identifikuara. Por këto burime ujore nuk ndodhen në brendësi të pronës në vlerësim, por në një distancë të afërt. Burimi ujqor më i afërt është Lumi Shkumbin. Përsa i përket distancave që objekti ruan me këto burime ujore sqarojmë se Shtrati i Lumit Shkumbin kalon rreth 1.15km në vijë ajrore në jug të objektit. Zona është me relief të sheshtë dhe ndodhet në brendësi të Kombinatit Metalurgjik. Objekti nuk ndodhet në brendësi të burimeve ujore të rëndësishme si Liqene, Laguna apo zona Bregdetare.

c. Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundëshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër

Nisur nga vlerësimi i projektit për “Fonderi për Prodhimin e Materialeve të Gizës”, veçorive kryesore të projektit dhe inspektimit në vend i sipërfaqes ku do të kryhet aktiviteti industrial, është bërë identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të mundëshme në mjedis që do të jenë gjatë shfrytëzimit të objektit të Fonderisë.

Në përputhje me Udhëzimin Nr.6 dt 27/12/2006 “Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis të një veprimtarie” me këto identifikime dhe vlerësime është plotësuar tabela I e aneksit II të këtij udhëzimi për të analizuar në mënyrë të detajuar vlerësimet sasiore të ndikimeve në mjedis nga zbatimi i projektit.

ANEKSI II PJESA E PARË

Tabela Nr.31 KLASIFIKIMI I RAPORTIT TË VLERËSIMIT NË MJEDIS për Projektin “Fonderi për Prodhimin e Materialeve të Gizës”,Njësia Administrative Bradashesh, Bashkia Elbasan

Nr	Pyetje që duhen marrë parasysh për klasifikim gjatë ushtrimit të veprimtarisë	Po /jo	Përshkruaj shkurtimisht. Do të ketë ndërveprime ndikime të rëndësishme Po /Jo	Përse
1	Do të shkaktohen ndryshime fizike në territor (në topografinë, përdorimin e tokës ose burimet ujore etj.)	Jo	Jo	Gjatë realizimit të prodhimit të Gizës nuk ka ndryshime në territorin e objektit ekzistues
2	Do të përdoren burimet natyrore si: toka, uji, materiale ose energji, veçanërisht ato burime që nuk janë të rinovueshme	Po	Jo. Uji që do të përdoret është proces riciklimi dhe nuk ndikon në tokën e objektit	Do të shfrytëzohen një pjesë ujrave natyrore për ftohjen e aparateve të prodhimit, furrat me induksion dhe kovat e shkarkimit
3	Parashikohet përdorimi, magazinimi, transporti apo prodhimi i substancave ose materialeve të dëmshme për shëndetin dhe mjedisin	Po	Gjatë ushtrimit të aktivitetit “Fonderi për Prodhimin e Materialeve të Gizës”, krijohen avuj që kanë ndikime në ambjent.	Gjatë aktivitetit “Fonderi për Prodhimin e Materialeve të Gizës”, ka pak shkarkime të gazrave në atmosferë
4	Do të prodhohen mbetje të ngurta	Po	Po. Mbetje të ngurta do të jenë mbetjet e procesit të prodhimit të Gizës në formë dherash, rëre dhe mbetje të tjera	Mbetjet industriale të gjeneruara nga procesi i prodhimit të Gizës dhe metaleve të derdhura prej gize depozitohen në sheshin e përcaktuar nga shoqëria, brenda kushteve teknike për depozitimin, magazinimin, transportimin dhe asgjësimin përfundimtar të tyre nga subjekte të licencuara.

5	Do të ketë shkarkime në ajër të ndotësve, substancave të rrezikëshme, toksike	Jo	Gjatë procesit të prodhimit të Gizës ka shkarkues në ajër.	
6	Do të ketë zhurma e vibrime apo çlirim drite, energji ose rrezatim elektro magnetik	Po	Me zhurma shoqërohet i gjithë procesi teknologjik por që janë të papërfillshme për zonën industriale ku punohet.	Do të kenë ndikime jashtë ambjenteve të punës dhe do të jenë objekt i monitorimit.
7	Do të ketë rrezik për ndotje të tokës dhe të ujrave nga shkarkimet e ndotësve mbi sipërfaqen e tokës, ujrave sipërfaqësore, nëntokësore	Jo	Nuk ka rrezik të ndotjes së tokës dhe të ujrave	Ujrat industrialë dekantohen, filtrohen nga mbetjet dhe pastaj kalojnë në kanalizimet e ish KM
8	Ka rrezik për aksidente që mund të ndikojnë në shëndetin e njerëzve apo të mjedisit	Po	Në rast të mos zbatimit të rregullave të sigurimit teknik atyre tëmkz. si dhe rregullave të manovrimit për çdo operacion pune	Në rast të shkeljes së këtyre rregullave ka premisa për ngjarje me pasoja të riparueshme në shëndetin e punonjësve dhe mjedis
9	Do të ketë ndikime sociale (demografike, në mënyrën tradicionale të jetesës, në punësimin e njerëzve etj.)	Jo	Jo	Efekt pozitiv ka punësimi i njerëzve qëdo të punojnë në prodhimin e furrave të Gizës
10	Ka zona të mbrojtura nga legjislacioni për vlerat e tyre të biodiversitetit, ekologjike, panoramike, kulturore historike, arkeologjike	Jo	Zona ku ndodhet objekti për Fonderi për Prodhimin e Materialeve të Gizës ndodhet larg zonave të mbrojtura	Çdo dëmtim i sipërfaqes së tokës dhe i ndotjes së ujërave të zonës mund të prishë ekuilibrat natyrore ekologjike
11	Ka zona të ndjeshme mjedisore, si ligatina, zona bregdetare, male, pyje, kullota, florën e faunën e egër, dru frutore etj në zonë	Jo		
12	Ka zona me specie të mbrojtura, të rëndësishme ose të ndjeshme, të kërcënuara, të rrezikuara, në rrezik zhdukje tëfaunës e florës	Jo	Mbetjet që krijohen në zonë do të largohen nga objekti për të mos shqetësuar zonën e banuar.	
13	Ka zona me ujëra tokësore, nëntokësore apo detare në zonë	Jo	Jo. Përbërja gjeologjike e zonës tregon se çdo derdhje e ujërave sipërfaqësore ndikon në ujërat nëntokësore të zonës dhe ujrat e Lumit Shkumbin	Ujrat e përdorur për ftohje riciklohen dhe hyjnë përsëri në qarkullim për ftohjen e furrave dhe mureve të kovave të shkarkimit
14	Ka zona me tipare të spikatura panoramike ose skenike në zonë	Jo	Jo. Rruga është me ndërtesa industriale në të dy krahët	
15	Ka rrugë apo infrastruktura të ngjashme që përdoren nga	Jo	Jo. Aktiviteti prodhues do të kryhet pranë Rrugës së	Mjetet që furnizojnë me lëndë të parë dhe ato që

	publiku për të shkuar në vend pushime etj		brendëshme që lidh Kombinatin Metalurgjik me Njësinë Adminis. Bradashesh	transportojnë materialet e prodhuara prej gize nuk i kalojnë 1-2 në ditë
16	Ka përdorime egzistuese të tokës ose plane të ardhëshme që mund të ndikohen	Jo	Jo.	
17	Është zona nën rrezikun e ndotjes ose dëmtimeve mjedisore	Po	Po. Aktiviteti prodhues iFonderisë së Gizës zhvillohet në një zonë me problem të ndotjes, ish KME	
18	Është zona me probleme për sa i përket tërmeteëve, rrëshqitjeve të dheut, erozionit përmytjeve, kushteve ekstreme klimaterike	Po	Po. Zona është 8 ballë	Objekti ku zhvillohen proceset për Fonderi për Prodhimin e Materialeve të Gizësështë ekzistues, i ndërtuar me planimetri të rregullt, me koeficient të lartë sigurie në rastet e mundshme të tërmeteëve.

ANEKSI II PJESA E PARË

Tabela Nr.32 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS TË VEPRIMTARISË DHE ÇËSHTJET MJEDISORE QË DO TË TRAJTOHEN NË RAPORTIN E VNM-së për “Fonderi për Prodhimin e Materialeve të Gizës”

Nr	Pyetje që duhen marrë parasysh për klasifikim gjatë ushtrimit të veprimtarisë	Po/Jo	Cilët elementë të mjedisit mund të ndikojnë e si	Do të jetë ndikimi domethënës në mjedis? Pse
1.A do të përfshijë ndërtimi, operimi ose mbyllja e veprimtarisë dhe montimi i teknologjisë dhe paisjeve veprime që shkaktojnë ndryshime fizike në topografi, përdorim toke, ndryshime në trupat ujore etj?				
1.1	Ndryshime të përkohëshme ose të përherëshme në përdorimin e tokës ose topografi duke përfshirë rritjen e intesitetit të përdorimit të tokës	Jo	Objekti është ekzistues	Ndryshimi i destinacionit të tokës është parashikuar brenda normave për përdorimin e saj në zonën industriale të Kombinatis Metalurgjik.
1.2	Pastrim toke egzistuese, vegetacionit dhe ndërtimeve egzistuese	Jo	Vegetacioni i tokës është ekzistues	Mund të mbillen nga subjekti “ENIRA - METAL” shpk pemë të zonës në territorin e saj
1.3	Krijimi i përdorimeve të reja të tokës	Jo	Aktiviteti është ekzistues	Jo
1.4	Investigim para fazës ndërtimore, si shpime për marrje mostre, provat e tokës, dheut	Jo	Ativiteti prodhues nuk ka të bëjë me ndërhyrje në tokë.	
1.5	Punime ndërtimi	Jo	Aktiviteti për “Fonderi për	Jo.

			Prodhimin e Materialeve të Gizës”është ekzistues	
1.6	Punime prishje?	Jo		
1.7	Kantjere të përkohëshme për punime ndërtimi ose strehim punëtorësh	Jo	Do të shfrytëzohen objektet ekzistuese	Jo
1.8	Punime mbitokësore, struktura ose punime të tokës, gërmime/mbushje	Jo		
1.9	Punime bonifikuese	Jo	Nuk ka të tilla	
1.1 0	Gërmime për hapje kanalesh	Jo	Nuk do të ketë ndryshime në strukturën e tokës	
1.1 1	Proçese të ndryshme prodh.	Po	Zhvillohet procesi i “Prodhimit tëGizës dhe materialeve prej gize”	Do të ketë ndikim në mjedis dhe procesi do të jetë i monitoruar gjatë gjithë kohës
1.1 2	Mjedis për magazinim mallrash e materiale	Po	Do të jetë me sip.të vogël dhe ekzistuese	
1.1 3	Impiante për trajtim ose depozitim të mbetjeve të ngurta e të lëngëshme	Po	Vendi për grumbullimin e mbetjeve të ngurta është i përcaktuar	
1.1 4	Objekte strehimi të punëtorëve të shfrytëzimit	Jo		
1.1 5	Mbyllje apo devijim i rrugës egzistuese	Jo		
1.1 6	Linja apo tubacione të reja transferuese transmetimi	Jo		
1.1 7	Rezervuare, argjinatura, kanale nëntokësore etj.	Jo	Janë ekzistuese	
1.1 8	Ndryshime në trupat ujore ose në sipërfaqet e tokës që ndikojnë	Jo		
1.1 9	Transportin e personelit e materialeve të ndërtimit	Jo		
1.2 0	Punimet afatgjatë, çmontimi, nxjerrja e mbeturinave ose punime restauruese	Jo	Jo	
1.2 1	Veprimtari gjatë ndryshimit të destinacionit që mund të ketë ndikim në mjedis	Jo		
1.2 2	Hyrjet e njerëzve në një zonë përkohësisht apo në mënyrë të vazhdueshme	Jo		
1.2 3	Humbje të specieve vendase ose diversitetet gjenetik?	Jo		
2. A do të përdoren gjatë fazës së shfrytëzimit të projektit burime natyrore të tilla si:toka, uji, materiale ose energji, ndonjë nga burimet që janë të parinovueshme ose të kufizuara?				

2.1	Toka veçanërisht e varfër apo bujqësore	Po		
2.2	Uji	Po	Uji i cili merret nga sistemi qëndror i shpërndarjes dhe përdoret në sasi minimale në teknologji	
Pyetje që duhet të mbahen parasysh gjatë përzgjedhjes				
2.3	Grumbullim lëndësh ndërtimi zhavore, rërë, betone lëndë asfaltuese etj mbetjesh metalike të karakterit ferore.	Jo	Për procesin teknologjik do të jetë lënda e parë dhe ajo ndihmëse	Janë marrë të gjitha masat që të mos ketë ndikime në mjedis
2.4	Energji elektrike apo lëndë djegëse	Po	Nuk do të ketë ndikim në mjedis. Energjia elektrike shërben për vënien në punë tëfurrave të gizës makinerive dhe paisjeve	Po. Energjia elektrike do të përdoret për procesin teknologjik dhe do të jetë në sasi të konsiderueshme
3. A do tëpërfshijë projekti përdorimin, ruajtjen, transportin, përpunimin dhe prodhimin e substancave ose materialeve që mund të jenë të dëmshme për shëndetin e njeriut ose mjedisin dhe që rrisin shqetësimin mbi rreziqet aktuale dhe të mundëshme në shëndetin e njerëzve				
3.1	A parashikon projekti përdorimin e substancave ose materialeve të rrezikëshme ose toksike për ambjent)	Po	Materialetndihmësejan ë materia që paraqet rrezik për shëndetin e njerëzve	Gjatë procesi të prodhimit do të ketë materiale që kanë efekt negativ në ambjent, por do të merren të gjitha masat mbrojtëse për ruajtjen mjedisit dhe të jetës së punonjësve
3.2	Do të ndikojë projekti në mirëqenien e njerëzve	Po	Impakt pozitiv	Punësim të njerëzve në industrinë e prodhimit, rritet lëvizshmëria dhe mirëqenia sociale e punonjësve
3.3	A ka grupe njerëzish që mund të ndikohen nga projekti	Jo		
3.4	Shkaqe të tjera	Jo		
4. A do të prodhohen mbeturina të ngurta gjatë shfrytëzimit ose nxjerrjes jashtë funksionit				
4.1	Mbeturina dherash, zhavore, betone, bitume ose minerale	Po	Gjatë procesit të prodhimit të gizës krijohen mbetje të ngurta që do të largohen për në vendet e caktuara me kontinierët e Kombinatit Metalurgjik	Mbetjet e krijuara nga proceset e prodhimit kanë ndikim negativ në mjedis duke prishur pamjen vizuale të zonës industriale, ndotin ujin që ndodhet në sheshin e fonderisë. Ato ndikojnë negativisht në florën faunën dhe tokën e zonës.
4.2	Mbetje urbane (shtëpiake dhe	Po	Mbetjet që krijohen nga	Jo. Nuk do të kenë asnjë lloj

	ose nga tregtia)		personeli punonjës 3-5 kg në ditë	ndikimi në mjedis. Ato largohen nga Bashkia Elbasan
4.3	Mbetje rrezik-toksike	Jo		
4.5	Ujëra të zeza ose llumra të tjerë nga trajtimet e shkarkimeve të lëngëta	Jo	Në sasi minimale do të ketë ndotje të ujërave industriale ose nga llumrat që mund të krijohen në ditët me shi, por që largohen me sistemin e ujrave sipërfaqësorë	Jo. Sasitë e këtyre mbetjeve do të jenë tepër minimale dhe normat do të jenë brenda kërkesave mjedisore.
4.6	Mbetje nga ndërtimet apo shembjet	Jo		Jo.
4.7	Mbeturina makinash ose paisjesh	Jo		
5. A do të shkaktohen ndotje në ajër ose çdo substancë tjetër e rrezikshme toksike apo të dëmshme për shëndetin nga projekti				
5.1	Shkarkim nga djegia e karburanteve nga burime stacionare të lëvizëshme	Po	Mjetet e transportit dhe ato teknologjike që punojnë me karburante kanë shkarkimin e gazeve të djegies në ambientet e lira. Gjatë procesit do të ketë çlirime gazi në atmosferë por që do të jenë objekt i monitorimit	Po. Kanë ndikime minimale në mjedis.
5.2	Shkarkime nga proceset prodhuese	Po		Po. Kanë ndikime në mjedis. Shkarkimi i tyre do të bëhet brenda normave të vendosura dhe do të monitorohen gjatë procesit të “Fonderisë për Prodhimin e Materialeve të Gizës”
5.3	Shkarkime nga përpunimi i materialeve përfshi depozitimin apo transportin	Jo		
5.4	Shkarkime nga aktiviteti përfshi impiantet dhe paisjet	Po	Shkarkimet do të jenë në formëgazi, avujsh dhe mbetje të ngurta	Po. Kanë ndikime të përkohshme në ajër dhe tokë dhe krijojnëndotje.
5.5	Mbetje apo erëra sulmuese nga përpunimi i materialeve të ndërtimit, ujërat e zeza e mbetjet	Po	Në rast difektesh	Ato mund të dëmtojnë rrugët e frymëmarrjes dhe mund të dëmtojnë lëkurën
6. A do të shkaktojë projekti zhurma dhe vibracione ose emetime të dritës, energjisë termike ose rrezatimit elektromanjetik?				

6.1	Nga puna e paisjeve si: motorra, sisteme lëvizëse, automjete etj	Po	Do të ketë lëvizje për furnizimin me lëndë të parë	Po. Zhurma do të jetë brenda normave të lejuara dhe e përkohshme. Gjatë procesit të derdhjes së formave ka energji termike por është e vogël
6.2	Nga ndërtime apo prishje	Jo	Objekti është ekzistues	Jo
6.3	Nga plasjet apo futje pilotash	Jo		
6.4	Nga trafiku gjatë shfrytëzimit	Jo	Trafik ka si në drejtim të furnizimeve me lëndë të para, ndihmëse etj. si dhe tërheqje tëmbetjeve	Jo
7. A do të çojë projekti në rreziqe të ndotjes së tokës ose ujit nga shkarkimet e ndotësave në tokë ose në kanalizimet e ujërave të bardha dhe të zeza, ujërat sipërfaqësore, nëntokësore, bregdetare ose në det?				
7.1	Nga përpunimi, depozitimi, përdorimi ose shkarkimi materialeve të rrezikëshme e toksike?	Po	Duhet të zbatohen të gjitha masat e MKZ dhe transportit të materialit të parë	
7.2	Nga shkarkimi i ujërave të zeza ose rrjedhjeve tjetra (trajtuar e patrajtuar) në ujë ose tokë?	Jo		
7.3	Depozitimi i ndotësve të shkarkuar në ajër, ujë ose tokë	Jo	Procesi i prodhimit zhvillohet në një zonë që monitorohet nga ndotja	
7.4	Nga çdo burim tjetër?	Jo		
7.5	A ka rrezik të ndonjë akumulimi afatgjatë të ndotësave në mjedis nga këto burime?	Jo		
8. Egziston rreziku i aksidenteve gjatë ndërtimit apo shfrytëzimit të projektit që mund të ndikojë në shëndetin e njerëzve apo mjedis?				
8.1	Nga shpërthime, zjarre, nxjerrje etj. Nga depozitimi, i subst.të rrezikshme e toksike?	Po	-Rrezik djegie	Janë marrë të gjitha masat për eliminimin e rreziqeve të tilla
8.2	Nga ngjarje që kapërcejnë kufijtë e mbrojtjes normale të mjedisit	Jo		
8.3	Mund të ndikohet projekti nga fatkeqësi natyrore që shkaktojnë dëme për mjedisin (përmbytje, tërmete shkarje dheu etj)	Po	Objekti është i llogaritur për tërmete 8 ballë	Po. Objekti është i pajisur me sistem funksional kanalizimi dhe shkarkimi të ujërave.
9. A rezulton projekti me ndryshime sociale, si p.sh. demografi, mënyrë tradicionale jetese, punësim?				

9.1	Ndryshim në madhësinë e popullsisë, moshën, strukturën e saj, grupe sociale etj.	Jo		
9.2	Nga strehimi i njerëzve apo prishja e shtëpive, mjediseve të komunitetit	Jo		
9.3	Nëpërmjet migrimit të banorëve të rinj ose krijimit të komunave të reja	Jo		
9.4	Nga realizimi i kërkesave në rritje për mjedisin e shërbimeve sociale si strehim, arsim shëndet ?	Po		
9.5	Nga krijimi i vendeve të punës gjatë ndërtimit ose shfrytëzimit apo humbjes së vendeve të punës me pasoja në papunësi e ekonomi?	Po	Impakt pozitiv	Impakt pozitiv nga punësimi përaktivitetin “Fonderi për Prodhimin e Materialeve të Gizës”
10. A do të çojë projekti në një presion për zhvillim të mëtejshëm që mund të ketë ndikim të rëndësishëm në mjedis p.sh. më shumë banesa, rrugë të reja, industri apo veprimtari mbështetëse?				
10.1	Do të çojë projekti në presione për zhvillime të mëtejshme që do të kenë ndikim të caktuar në mjedis si: më shumë strehime, rrugë të reja, industri apo shërbime publike mbështetëse	Po		Po.
10.2	Cënon projekti në zhvillimin e mjediseve mbështetëse, në zhvillime ndihmëse që mund të ketë ndikim në mjedis si: 1.Infrastruktura mbështetëse (rrugë, furnizim me energji elektrike, trajtim të mbetjeve ose ujrave të përdorura etj.) 2.Zhvillimi i strehimit 3.Industri nxjerrëse (ekstraktuese) 4.Industri furnizuese	Jo Jo Jo Po		
10.3	A do të çojë projekti në një ripërdorim të tij pas shfrytëzimit që do të ketë një ndikim në mjedis	Jo		
10.4	A do të çojë projekti në krijimin e një precedenti për zhvillime të mëvonëshme	Jo		Jo

ANEKSI II PJESA DYTË

Tabela Nr.37 Karakteristikat e mjedisit ku zhvillohet projekti për aktivitetin “Fonderi për Prodhimin e Materialeve të Gizës”

Pyetje	Shpjegime
A ka tipare të mjedisit lokal apo përreth vendndodhjes së projektit të cilat mund të ndikohen nga projekti?	
<ul style="list-style-type: none"> • Zona të cilat janë të mbrojtura nga legjislacioni ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor për vlerat e tyre ekologjike, peisazhike, kulturore dhe vlera të tjera të cilat mund të ndikohen nga projekti • zona të tjera të cilat janë të rëndësishme ose të ndjeshme për arsye të ekologjisë së tyre psh: ligatina • rrjedha ujore ose trupa të tjerë ujore • zona bregdetare • male • pyje 	<p>Jo</p> <p>Jo</p> <p>Jo</p> <p>Jo</p> <p>Jo</p> <p>Jo</p>
2. Zona të përdorura nga specie të pambrojtura të rëndësishme ose të ndjeshme të florës dhe faunës	Jo
3. Ujrat e brendshëm tokësore, bregdetare detare dhe nëntokësore	Jo
4. Zona me vlera të larta peisazhike apo skenike	Jo
5. Rrugë ose mjedise të tjera të përdorura nga publiku për pushime apo aktivitete të tjera	Jo
6. Rrugë transporti që janë të mbingarkuara ose shkaktojnë probleme mjedisore.	Po
7. Zona me rëndësi historike apo kulturore	Jo
Është vendosur projekti në një zonë që është shumë e dukshme nga shumë njerëz?	
1. Është vendosur projekti në një zonë që është shumë e dukshme nga shumë njerëz	Po
Është vendosur projekti në një zonë të pa zhvilluar më parë ku do të kemi humbje të tokës, gjelbërimit?	
1. Është vendosur projekti në një zonë të pa zhvilluar më parë ku do të kemi humbje të tokës, gjelbërimit?	Jo.
Ka përdorim egzistues të tokës në/ose rreth vendit të zbatimit të projektit të cilat mund të ndikohen nga projekti?	
a. shtëpi, oborre apo prona të tjera private	Po, godina ekzistuese industriale
b. industri	Po
c. tregti	Jo
d. rekreacione	Jo
e. hapësira publike	Jo
f. mjedise të komunitetit	Jo
g. bujqësi	Po
h. pyje	Jo
i. turizëm	Jo
j. karriera ose miniera	Jo, nuk ka
Ka plane për përdorime të ardhshme të tokës në ose rreth vendit të zbatimit të projektit, të cilat	

mund të ndikohen prej tij?	
Ka plane për përdorime të ardhshme të tokës të cilat mund të ndikohen prej tij?	Punimet kryhen në përputhje me studimin e zonës për Njësinë Administrative Bradashesh
Ka ndonjë zonë në/ose rreth zonës së zbatimit të projektit të zëna nga përdorime të ndjeshme të tokës të cilat mund të ndikojnë prej tij?	
1. Spitale	Nuk ka
2. Shkolla	Nuk ka
3. Vende Kulti	Nuk ka
4. Mjedise të komunitetit	Jo
Ka ndonjë zonë përreth projektit e cila përmban burime të rëndësishme, me një cilësi të lartë ose të pakta të cilat mund të ndikohen nga projekti	
1. Burime ujërash nëntokësore	Jo
2. Ujëra sipërfaqësore	Jo
3. Pyje	Jo
4. Bujqësi	Po
5. Peshkim	Nuk ka
6. Turizëm	Jo
Ka ndonjë zonë përreth zonës së zbatimit të projektit që është aktualisht subjekt i ndotjes ose dëmtimeve mjedisore p.sh. ku standartet egzistuese mjedisore ligjore janë tejkaluar të cilat mund të ndikohen nga projekti?	
1.Ka ndonjë zonë në dhe përreth zonës së zbatimit të projektit që është aktualisht subjekt i ndotjes ose dëmtimeve mjedisore	Po. Kombinati Metalurgjik, Fabrika Çimentos
Është zona e zbatimit të projektit e ndjeshme ndaj tërmeteve, rrëshqitjeve të tokës, erozionit, përmblytjeve apo kushteve klimaterike të pafavorshme apo ekstreme?	
1. Është zona e zbatimit të projektit e ndjeshme ndaj tërmeteve, rrëshqitjeve të tokës, erozionit.	Po, Objekti është llogaritur për sismicitet 7-8 ballë
A ka të ngjarë që projekti të ndikojë në ndryshime të kushteve fizike të ndonjë nga përbërësit e mjedisit?	
1.Mjedisi atmosferik, përfshi mikroklimën, kushtet klimaterike lokale ose të një shkalle më të madhe	Jo
uji p.sh. sasia, rrjedhat apo nivelet e lumenjve liqenet ujërat nëntokësore, grykëderdhjet, ujërat bregdetare apo detare	Jo
3. Statusi ushqyes dhe eutrofikimi i ujërave	Jo
4. Acidifikimi i tokave apo ujërave	Jo
5. Toka	Jo
6. Zhurma	Po
7.Temperatura, rrezatimet ndriçuese apo elektro magnetike përfshi ndërhyrjet elektrike	Jo
8. Produktiviteti i sistemeve natyrale ose bujqësore	Jo
A ka të ngjarë që projekti të ndikojë në disponibilitetin apo pamjaftueshmërinë e burimeve të mundëshme në nivel lokal apo global?	
1. Karburante	Jo
2. Ujëra	Jo

3. Minerale dhe agregate	Jo
4. Burime të tjera të rinovueshme	Jo
5. Kapacitetin e infrastrukturës në vend: ujërat e zeza, prodhimi i energjisë dhe transmetimi i saj, telekomunikacion, rrugët për depozitim të mbeturinave, hekurudhat	Po. Rritet sasia e energjisë së përdorur për procesin e prodhimit
A ka të ngjarë që projekti të ndikojë në shëndetin ose mirëqënien e komunitetit në zonë?	
Cilësinë e ajrit, ujit, ushqimet dhe çdo produkt të konsumuar nga njeriu	Jo
Shfaqjes apo përhapjes së bartësve të sëmundjeve	Jo
Ndjeshmëria e individëve të veçantë, komuniteteve ose popullatave ndaj sëmundjeve	Jo
Perceptimi individual i sigurisë personale	Po. Është parashikuar të merren të gjitha masat e mbrojtjes për shëndetin dhe jetën e punonjësve
Kushtet e strehimit	Jo
Punësim	Po. Efekt pozitiv
Kushtet ekonomike	Po. Ndikon në zhvillimin e industrisëprodhuese dhe të ekonomisë si të shoqërisë ashtu edhe të komunitetit ku kryen aktivitetin fonderia

ç. Një përshkrim për shkarkimet e mundëshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe përdorimi i mbetjeve. Shkarkimet e mundëshme në mjedis si ujra të ndotur, gazra, pluhra, zhurma, vibrime, prodhimi i mbetjeve

• Cilësia e ujrave në zonën e studjuar

Në zonën e studjuar cilësia e ujrave është e pastër. Ato janë ujra natyrale që vinë nga burimet e zonës dhe përdoren direkt për ujë të pishëm në zonë. Aktiviteti për prodhimin e Fonderisë së Gizës, mund tëndikojë në këto ujra nëqoftëse gjatë shfrytëzimit të projektit nuk do të funksionojnë në rregull kanalizimi i ujrave të përdorura dhe të ujrave të zeza. Derdhja e ujrave të zeza ndikon në nivelin e oksigjenit në zonë dhe në zhdukjen e florës dhe të faunës si dhe direkt në shëndetin e popullsisë.

Baseni i Shkumbinit. Rrjeti i monitorimit përbëhet nga katër stacione, Qukës, Topçias, Papër dhe Rrogozhinë, në të cilat vlerësohet gjendja e ujrave të këtij lumi në rrjedhën e sipërme, në rrjedhën e mesme dhe në rrjedhën e poshtme para derdhjes së lumit në det.

Në të katërt stacionet e basenit të Shkumbinit përmbajtja e oksigjenit të tretur është e lartë duke e klasifikuar të cilësisë shumë të mirë, ku vlera e tij varjon nga 9.5 mg/l në stacionin reference Qukës, në 8.2 mg/l në stacionin Ura e Rrogozhinës.

• Cilësia e ajrit në zonën e studjuar

Ndotësit kryesorë të cilët ndikojnë në cilësinë e ajrit janë: NO₂, O₃, SO₂, CO, PM₁₀, PM_{2.5} dhe benzeni të cilët emetohen nga djegia e lëndës fosile për energji dhe transport. Ozoni (O₃) është një ndotës sekondar i cili formohet nga oksidimi i ndotësve primarë në prani të rrezatimit diellor, i cili ndikon në ndryshimin e klimës globale. Oksidet e Sqfurit dhe Azotit në bashkëveprim me lagështirën e ajrit kthehen në acide dhe depozitohen në tokë në formën e shiut acid i cili është i dëmshëm për bujqësinë dhe për mjedisin në përgjithësi. Ndotja e ajrit nga kimikatet, grimcat e pluhurit, materialet biologjike shkaktojnë shqetësime ose dëmtime tek njerëzit dhe organizmat e tjera duke ndikuar negativisht në mjedisin natyror. Burimet e ndotjes së ajrit mund të kenë origjinë natyrore ose antropogjenike. Efektet shëndetësore shkaktuar nga ndotësit e ajrit klasifikohen si ndryshime fiziologjike dhe biokimike të lehta deri në vështirësi në frymëmarrje, nuhatje, kollitje dhe probleme kardiake e respiratore.

Për zonën në studim ka të dhëna zyrtare të monitorimit të cilësisë së ajrit. Monitorimi është kryer për zonat kryesore të zhvillimit urban dhe industrial.

Gjatë funksionimit të këtij aktiviteti, subjekti duhet të sigurohet që për ajrin, cilësia e mjedisit të jetë brenda normave të lejuara me ligj dhe konkretisht sipas normave të mëposhtëme:

Tabela Nr.38

PM10	PM2.5	NO ₂	O ₃	SO ₂		
ug/m ³	ug/m ³	ug/m ³	ug/m ³	ug/m ³		
Norma shqiptare		60	15	60	65	60
Standarti I BE		40	25	40	-	-

Në zonën në vlerësim, mendohet që cilësia e ajrit të jetë e mirë, kjo bazuar edhe në zhvillimin e kësaj zone, kushtet e mjedisit natyror, si dhe mungesa e industrisë e zhvillimit urban.

Transporti urban dhe ai privat

Transporti mbetet një nga burimet kryesore të ndotjes së ajrit urban. Gjatë funksionimit tëFonderisënumri i automjeteve në zonë do të rritet por kjo nuk do të ketë ndikim të ndjeshëm në ajrin e zonës pasi sasia e tyre do të jetë e vogël dhe nuk mund ti kalojë1 automjet në orë.

- Eshtë e domosdoshme që të merren të gjitha masat e duhura për mbrojtjen e sipërfaqes nga vajrat që mund të derdhen nga makinat e përdorura duke i parkuar ato në vende të caktuara dhe të mbrojtura mirë.

Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit

Në sektorin e ajrit janë identifikuar katër qëllime kryesore. Dy prej tyre kanë lidhje me pakësimin afatshkurtër të ndotjes së mjedisit. Ndërsa qëllimet e mëtejshme janë kritike për vazhdimin e mbrojtjes së ajrit, dmth grumbullimi i të dhënave mbi cilësinë e ajrit të mjedisit dhe një sistem i planifikimit dhe kontrollit që do të sigurojë arritjen e objektivave të cilësisë së ajrit në një periudhë afatgjatë.

Objektivat kryesore janë:

- ❖ Pakësimi me 50% i numrit të rasteve të mospërputhjes me objektivat e cilësisë së ajrit
- ❖ Pakësimi i shkeljeve të standardeve të cilësisë së ajrit
- ❖ Zbatimi i një sistemi kombëtar të monitorimit të cilësisë së ajrit në përputhje me kërkesat e Komunitetit Evropian

- ❖ Krijimi i një sistemi planifikimi të menaxhimit të cilësisë së ajrit në shkallë kombëtare dhe vendore

Masa

- Përafrimi i standarteve të karburanteve për automjetet me ato të standarteve Evropiane.
- Përmirësimi i kuadrit ligjor lidhur me importimin e automjeteve në drejtimim të vitit të prodhimit dhe cilësisë së motorëve.
- Reduktimi i zonave të ndërtimit dhe shtimi i hapësirave të gjelbërta

Rekomandime

Meqenëse ndotësi kryesor i PM₁₀ është shkarkimi i automjeteve rekomandohet:

- Kontrolli i cilësisë së lëndës djegëse që përdorin automjetet për transportin e lëndës së parë dhe shpërndarjen e prodhimit të Fonderisë së Gizës.
- Kontrolli i shkarkimeve të automjeteve me qëllim mos lejimin e makinave që nuk janë të mirëmbajtura.

Përsa i përket nivelit të zhurmave në zonën kuzhillohet aktiviteti i fonderisë, tani për tani janë të nivelit të ulët. Parametrat e zhurmave janë standarte të zonës industriale. Gjatë kryerjes së proceseve teknologjike për aktivitetin “Fonderi për Prodhimin e Materialeve të Gizës” zhurmat do të bëjnë presjon mbi mjedisin, por ky presjon është brenda standartit të teknologjise prodhuese.

• Administrimi i mbetjeve

Problemet e gjenerimit të mbetjeve dhe administrimit të tyre janë të shumta. Sasitë më të mëdha të mbetjeve të gjeneruara prirën të jenë substanca inerte. Mbetjet e procesit teknologjik do të përpunohen dhe largohen nga kompani të specializuara për mbetje teknologjike dhe mbetjet e ngurta urbane do të largohen menjëherë nga zona për në vendin e caktuar nga Bashkia Elbasan. Mbetjet urbane që do të krijohen gjatë funksjonimit të Fonderisë së Gizësdo të grumbullohen në konteniere të vendosur nga Bashkiaose vetë shoqëria “ENIRA - METAL” shpk.

• Problemet e tjera : si erozioni i tokës, zjarret, etj.

Gjendja e tokave është e rëndësishme për bujqësinë, pylltarinë dhe biodiversitetin. Nga ana e tyre këta janë të rëndësishme për ekonominë, shëndetin publik dhe turizmin. Dy janë problemet kryesore dhe më shqetësuese: Erozioni dhe prishja e ciësisë së tokës.

Erozioni

Nivelet e larta të erozionit paraqesin një sërë problemesh dhe të gjitha janë të pranishme sot në Shqipëri, përkatësisht: vendi ku zhvillohet procesi i prodhimit të Gizës nuk paraqet rrezikshmëri për erozion.

Tërmetet

Objekti ku zhvillohen proceset për Fonderi për Prodhimin e Materialeve të Gizës është ekzistues, i ndërtuar me planimetri të rregullt dhe duke respektuar me rigorizitet projektin teknik, me koeficient të lartë sigurie në rastet e mundshme të tërmeteve.

Përmbytjet

Objekti dhe sheshet ku zhvillohet veprimtaria nuk ndodhen në brendësi të burimeve ujore të rëndësishme, si Liqene, Laguna apo zona Bregdetare. Ai ndodhet në brendësi të ish Kombinatit Metalurgjik, në një distancë rreth 1.15 km nga Lumi Shkumbin. Zona në fjalë, gjatë 100 vjeçarit të fundit, nuk ka patur problematikë nga përmbytjet. Objekti është i pajisur me sistem funksional kanalizimi dhe shkarkimi të ujërave.

d. Informacion për kohëzgjatjen e mundëshme të ndikimeve negative të identifikuara për projektin “Prodhimin e Dioksidit të Squfurit të Lëngët, SO₂”, Njësia Administrative Bradashesh, Bashkia Elbasan”

Ndikimet negative në mjedis

Vlerësimi i ndikimeve të mundëshme si pasojë e veprimtarisë bëhet duke u nisur edhe nga një sërë faktorësh që lidhen me natyrën e veprimtarisë si: teknologjinë e përdorur, mënyrën e operimit, sasia e energjisë, mbetjet e gjeneruara, aktivitetin biologjik dhe social-ekonomik. Procesi për “Fonderi për Prodhimin e Materialeve të Gizës” shoqërohet me ndikime mjedisore. Për nga natyra e veprimtarisë dhe mënyra se si është parashikuar shfrytëzimi i objektit, ndikimet mund të analizohen sipas fazave të veprimtarisë dhe konkretisht:

- Në fazën e lëvizjes së lëndës së parëtë skrapeve për prodhimin e gizës
- Në fazën e procesit të prodhimit të Gizës në furrat e fonderisë
- Në fazën e derdhjes së gizës në format dhe kallëpet e materialeve që do të prodhohen
- Në fazën e transportit të materialit të prodhuar dhe shërbimit të zonës së industrisë.

Vlerësimi do të përqëndrohet nëkatër fazat. Ndikimet e çdo operacioni të përdorur, klasifikohen në dy grupe të mëdha sipas natyrës.

Informacion për shkarkimet në mjedis.

Ndikime të kthyeshme dhe Ndikime të pa kthyeshme

Të dy llojet e ndikimeve mund të minimizohen, ku qëllimi më i rëndësishëm është mbajtja e ndikimit brenda sipërfaqes sëçdo objekti dhe krijimi i kushteve natyrore për të siguruar riaktivizim të proceseve komplekse të natyrës dhe rigjenerimit të biodiversitetit të zonës ku zhvillohet aktiviteti për “Fonderi për Prodhimin e Materialeve të Gizës”.

Ndikimet negative në karakteristikat fizike të zonës së projektit

Gjatë ushtrimit të aktivitetit, nuk do të ketëndryshime të topografisë lokale duke patur parasysh se objekti është ekzistues dhe se ndryshimet e mëposhtme kanë ndodhur kohë më parë.

- Ndikimet në përdorimin e tokës dhe të burimeve
- Në cilësinë dhe sasinë e tokës së lirë.

Ushtrimi i aktivitetit në këtë zonë nuk ndikon negativisht në sasinë dhe cilësinë e tokës. Në zonën e shfrytëzuar, nuk janë parashikuar masa lidhur me ruajtjen dhe mbrojtjen e zonave arkeologjike apo historike, pasi nuk ka të tilla në të. Aktiviteti i ushtruar është kombinuar dhe me

funksionet e ndërhyrjeve inxhinjrike tëveprave të infrastrukturës si rrjeti i ujësjellësit, elektrike dhe ai i kanalizimeve të ujrave të zeza.

- **Ndikimet negative në habitate dhe biodiversitet të zonës së projektit**

Zona ku zhvillohet aktiviteti i “Fonderisë për Prodhimin e Materialeve të Gizës” nuk është e mbushur me bimësi. Aktualisht flora dhe fauna në zonën për të cilën bëhet fjalë nuk është e zhvilluar në periferi dhe brendësi të projektit. Gjithsesi, as fauna dhe as flora egzistuese e zonës, nuk pëson ndryshim të ndjeshëm nga ky projekt. Aktiviteti i prodhimit nuk sjell influenca negative në folenizim, shumëzim etj. Gjatë fazës së shfrytëzimit nuk ka elementë shqetësues për dëmtimin e faunës dhe të florës. Po ashtu fauna karakteristike e zonës është e paprekshme nga ndikimet e shfrytëzimit të objektit, për arsye se aktiviteti i shfrytëzimit të ndërtimit nuk dëmton as në lloje, as në numër elementët e florës dhe faunës.

Tabela Nr. 33 Ndikimet në ambjent të jashtëm

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
Në florën dhe faunën	Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo
Shkatërrim i rëndësishëm i habitateve natyrore		X
Ndërtimi i rrugëve të reja që kalojnë në zonat e virgjëra		X
Rrezikimi i ndërhyrjes në bimët e ujit		X
Përçarje/izolim i habitanteve të egra		X
Interferenca midis rrugëve natyrore të emigrimit të sisorëve		X

- **Shkarkimet në mjedis dhe prodhimi i mbetjeve**

Mbetje të ngurta që mund të prodhohen janë ato të skorjeve që prodhon furra (Trajtë hekurash). Këto mbetje, prodhohen nga procesi në furrat e gizës ose mbetje në kovat e derdhjes së materialit të shkrirë të cilat futen dhe riciklohen përsëri në furrat e shkrirjes si lëndë e parë, që nuk ze më shumë se 1-2% te tij. Këto mbetje duke qenë në trajtë të ngurtë dhe të patretshme, nuk përbëjnë problem për kontenerin e mbetjeve të ngurta të Kombinatit Metalurgjik. Mbetjet e ngurta të cilat dalin nga materiali zjarrdurrues i furrave dhe kovavelargohen me mbetjet e ngurta të llojeve të tjera të gjithë kombinatit. Këto mbetje duhet të menaxhohen duke u depozituar dhe sistemuar kundër ekspozimit ndaj efektit të erozionit dhe përhapjes së tyre në mjedis. Këto mbetje duhet të menaxhohen nga një subjekt i licensuar dhe që plotëson kriteret për menaxhimin e tyre.

Shkarkimet në ajër.

Shkarkimet në ajër rezultojnë si efektenga aktiviteti prodhues i gizës. Do të shkarkohet dhe gaz karbonik nga djegja e lëndës djegëse.

Tabela Nr. 34

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
Në ajër	Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo

Prodhimi i pluhurit		X
Ndotje nga djegia e hidrokarbureve	X	
Ndotje nga CO,SO2,NOx	X	

Grimcat e lëngëta.Nuk ka asnjë llojë ndikimi nga çlirimi i ndonjë grimce të lëngët e çdo lloji natyre qoftë. Gjatë ushtrimit të teknologjise së prodhimit të gizës do të ketë përdorime të ujit në sasi të konsiderueshme dhe shkarkimi i tij nëkanalizime duhet të plotësojë kërkesat si më poshtë: Në zbatim të V.K.M. Nr. 177, datë 31.05.2005 ”Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”. Subjekti detyrohet të ruaj përcaktimet e poshtëshënuara për ujjrat e shkarkimit

Tabela Nr. 35

Parametrat	Vlerat e lejuara
pH	6-9
Lëndët në pezulli	50 mg/l
COD	150 mg/l
BOD-5	50 mg/l

Funksjonimi i aktivitetit të shfrytëzimit të objektit të prodhimit të gizës nuk sjell problem në sasinë e ujit në Njësinë Administrative Bradashesh.

Tabela Nr. 36

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
	Po	Jo
Në ujë	Gjatë shfrytëzimit	
Trajtimi i ujjrave të ndotur	X	
Ndotja e ujit nga pluhuri, derdhje aksidentale e substancave të tjera		X
Impakt sekondarë në ndotjen e ujit për tokat bujqësore, ujra n/tokësore		X
Modifikimi në drenazhimin e ujjrave natyrale		X
Ndotja e ujjrave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë nga llumrat	X	

Mbeturinat e ngurta dhe llumore

Karakterizohen nga materialet mbeturinë që dalin gjatëproçeseve të ushtrimit të teknologjisë se prodhimit. Këto materiale në formën e mbetjeve të ngurta kanë natyrë të inerteve dhe karakterit të ambllazheve të lëndëve të para që mund të jenë prej letre, plastike etj. Të gjithë këto mbetje do të largohen nga zona pas realizimit tëproçesit teknologjik të prodhimit të gizës dhe materialeve të derdhura.

Mbetjet e lëngëta.Kryesisht mbetjet e lëngëta përfaqësohen nga ujjrat e larjes së makinerive që punojnë përrreth subjektit. Në zonën ku do të punohet ato do të jenë të papërfillshme.

Ndikimet negative shtesë në cilësinë e mjedisit në zonën e projektit dhe burimet natyrore si mineralet, pyjet, burimet ujore

Ky projekt nuk prek bimësinë dhe me kalimin e kohës ky gjelbërim duke qenë e tipit shkurre dhe bimësi e ulët zëvendësohet sipas Planit të Reabilitimit të zonës për zbatimin e projektit për ambientet e gjelbërimit të objektit industrial.

Ndikimet në përfitimet e tokës. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë prodhuese të materialeve të gizës, nuk do të ketë ndryshime që lidhen me përfitime të tokës.

Ndikim në regjimin e ujrave nuk ka.

Ndikim nga zhurmat

Për zhurmat zbatohet Udhëzimi Nr.8 datë 27.11.2007 ”Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”. Zhurmat e çliuara do të jenë brenda normave dhe standarteve të miratuara për këtë qëllim.

Mbetjet e lëngëta. Nuk ka mbetje të lëngëta.

Ndikimet në qarkullim, transport dhe shëndetin e njerëzve

Tabela Nr. 37

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
Në shëndetin e njerëzve	Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo
Krijimi i çfarëdo rreziku apo mundësie për dëmtimin e shëndetit të njerëzve	Po.	
Krijimi i raportit të njerëzve me rreziqet e mundëshme për dëmtimin e shëndetit të tyre	Po.	

Ndikimi në klimë. Gjatë ushtrimit të aktivitetit nuk ka ndikime në klimën e kësaj zone.

Aromat sulmuese. Gjatë ushtrimit të aktivitetit të prodhimit ka emetime të aromave sulmuese të materialit të shkrirë, por ato janë pothuajse të papërfillshme.

Ndikime të tjera indirekte dhe sekondare që shoqërojnë projektin

Projektet e tjera si p.sh. rrugët e reja, kanalet e ujërave të zeza, banesat, linjat e energjisë, telekomunikacionit etj, nuk do të ndikojnë në ushtrimin e këtij aktiviteti, pasi në zonën që prek ky aktivitet, nuk ka elementë të infrastrukturës siç u përmend më lart.

Ndikimet shoqëruese të aktivitetit me projekte të tjera egzistuese ose të propozuara. Ushtrimi i këtij aktiviteti do të ndikojë pozitivisht në punësimin e popullsisë së Njësisë Administrative Bradashesh dhe në rritjen e standarteve të jetesës së punonjësve.

Tabela Nr. 38

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
Nëinteresin publik (infrastrukturë)	Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo
Zhvillimi i aktivitetit do të ketë nevojë në fushë të interesit publik		X
Energji elektrike	X	
Sistemim i komunikacionit		X
Sistemim i kanaleve të ujrave të zeza e të bardha		X
Sistemim të ujësjellësit		X
Mbetje të ngurta e sistemim të tyre	X	

• **Përshkrimi i pasojave të aksidenteve të mundëshëm me pasoja në mjedis.**

Nuk ka asnjë pasojë aksidentale në mjedise gjatë aktivitetit tëFonderisë për Prodhimin e Materialeve të Gizës

Karakteristikat e ndikimeve negative në mjedis

Për të shmangur dhe menaxhuar sa më mirë ndikimet negative në mjedis të shkaktuara nga elementët e përshkruar më sipër, subjekti nëpërmjet personelit të tij do të përpilojë dhe do të zbatojë një plan efikas menaxhimi të ndikimit në mjedis. Përmbajtja e këtij plani mbështetet në këto parime të zbatueshme.

Tabela Nr. 39

Çfarë	Si	Kush
Parandalim	<ul style="list-style-type: none"> ❖ Përzgjedhja e teknologjisë plotësisht të kontrolluar dhe moderne me pajtueshmëri mjedisore në fushën e teknologjisë së prodhimit tëGizës ❖ Paisja e territorit të linjës dhe ambjenteve të punës me sisteme përballimi të emergjencave dhe mbrojtjen nga zjarri ❖ Zbatimi rigoroz i rregullave të sigurimit teknik gjatë punës dhe ndërprerjes së saj duke zbatuar normat e vendosura për këtë qëllim ❖ Përdorimi i mjeteve mbrojtëse në punë si doreza, syze mbrojtëse, rroba pune, e tj ❖ Plotësimi i gjithë dokumentacionit figurativ që ka të bëjë me zbatimin e rregullave të manovrimit për çdo paisje, rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë si dhe atyre kundra zjarrit. Në vendet me precedentë vendosen parrulla paralajmëruese për aktivitetin e objektit industrial. ❖ Kontrolli mjekësor periodik i punonjësve. ❖ Tokëzimi i të gjitha paisjeve që punojnë me energji elektrike për të shmangur aksidente me pasoja 	Subjekti
Kontroll	<ul style="list-style-type: none"> ❖ Vendosja e rezervuarëve të ujit dhe të gjithë pajisjeve të MKZ-së ❖ Sigurimi i të gjitha pajisjeve të nevojshme për riparim, pastrim dhe ndërhyrje në raste emergjencash ❖ Sigurimi i ambalazhuesve të sigurt e rezistentë për mbetjet industriale 	Subjekti dhe stafi i tij

Ndërhyrje	<ul style="list-style-type: none"> ❖ Riparim i menjëhershëm i difekteve dhe avarive teknologjike ❖ Aktivizim i menjëhershëm i stafit dhe mjeteve të fikjes së zjarrit ❖ Njoftim i menjëhershëm i autoriteteve dhe njësive të specializuara në rast emergjencash (zjarrfikës, autoambulanca) 	Personeli dhe organet shtetërore të specializuara
Administrim	<ul style="list-style-type: none"> ❖ Përdorimi dhe ruajtja me përgjegjësi i të gjithë infrastrukturës dhe mjeteve të përkrahura më sipërtë Fonderisë për Prodhimin e Materialeve të Gizës 	Stafi i “ENIRA -METAL” sh.a

dh. Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapsinore të ndikimeve negative në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të

Kohëzgjatja e ndikimit.Ndikimi i aktivitetit në kushte normale funksionimi do të zgjasë për aq kohë sa zgjat edhe aktiviteti. Në kushte normale funksionimi, aktiviteti nuk ka ndikim mbi mjedisin, ndërsa në rast të ndonjë keqfunksionimi, apo avarie në sistem dhe në furrat e fonderisë së prodhimit të gizës, mund të ketë edhe fatkeqësi në jetën e punonjësve.

Ndikimi në mjedisin e zonës në kushte normale të punës, nuk përhapet në një distancë të largët, ndërsa përsa i përket difekteve dhe pakujdesive gjatë procesit të prodhimit në furra dhe derdhjes së gizës në format dhe kallëpet e përgatitura mund të shkaktohen avari të ndryshme me pasoja në mjedisin e repartit dhe jetën e punonjësve të fonderisë. Ndaj është shumë e rëndësishme që subjekti të zbatojë kushtet teknike në punë dhe të ruaj masa të larta sigurie fizike e kundër rënieve të zjarrit në objekt.

- **Lloji i ndikimeve të identifikuar (direkte dhe jo indirekte)**

Tabela Nr. 40 Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në tokë

	Ndikimi i mundshëm	Sqarim
1	Derdhja pa dashje e vajrave dhe lubrifikantëve nga mjetet e punës.	Ndonjë rast i rrallë i rrjedhjes gjatë difekteve dhe çarje të tubave si dhe ndërrimit të vajrave në turbina dhe transformatorët e energjisë elektrike

Tabela Nr. 41. Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në ajër.

	Ndikimi i mundshëm	Sqarim
1	Shkarkimi i gazrave të SO ₂ në sasi minimale	Në rast avarie në sistem, ose në rast aksidenti por edhe në kushte normale pune sado pak që të ekspozohet individi
2	Emetimi i zhurmave nga makineritë e prodhimit	Vlerat standart të emëtimit të zhurmave sipas teknologjisë së prodhimit të makinerive, kontroll teknik të makinerive të prodhimit

Mbas vlerësimit profesional dhe konsultimit me specialistët përkatës mbahet parasysh në planin e menaxhimit nga subjekti këto gjëra:

Rreziqe me pasoja në mjedis

1. Dëmtim habitatesh
2. Rënia e ndonjë zjarri në ambjentin e zonës së prodhimit dhe masat mbrojtëse gjatë funksionimit të aktivitetit për “Fonderi për Prodhimin e Materialeve të Gizës”.

Rreziqet me pasoja në mjedisin human dhe ekonomik

- Aksidentet e punonjësve gjatë procesit të prodhimit të Gizës dhe materialeve në objekt.
- Aksidentet si pasojë e rënies së zjarrit.

Rëndësia e ndikimeve negative.

Rëndësia ekologjike.

Kriteret lidhur me rëndësinë ekologjike përfshijnë funksione mjedisore të ekosistemeve dhe vlerat estetike.

- Efektet në habitatin e bimëve dhe kafshëve
- Speciet e rralla dhe në zhdukje në zonë.
- Kapacitetin mbajtës të ekosistemit, ndjeshmërinë dhe qetësinë e kafshëve në zonë.
- Bimësia e zonës.

Rëndësia sociale.

Efektet biofizike përkthehen në efekte mbi faktorë të vlerësuar nga njerëzit

- Efekte në shëndetin human dhe sigurinë që krijohen nga procesi i prodhimit të gizës.
- Humbje potenciale e llojeve dhe vlerave potenciale.
- Vlera rekreacioni dhe estetike.
- Nevojat e shoqërisë për burime natyrore dhe shërbime sociale.
- Nevojat për transport dhe infrastrukturë tjetër.

e. Mundësitë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin

Subjekti duhet të kujdeset për një mjedis të pastër, të rregullt, të gjelbëruar, të sigurtë dhe të pajisur me sinjalistikën dhe posterat sensibilizues përkatës për kushtet teknike dhe për mbrojtjen e mjedisit. Kështu subjekti ka detyrimin që të zbatojë kushte të larta higjienike, sigurie fizike dhe ndaj rënies së zjarreve në objekt. Mjedisin përreth objektit të ruhet i pastër dhe i këndshëm, të mos kontaminohet me materiale të tilla si lënda e parë apo skorje të ndryshme të mundshme.

Tabela Nr.42 Vlerësimi i rëndësisë së ndikimeve në mjedis të aktivitetit “Fonderi për Prodhimin e Materialeve të Gizës”

Receptori i ndikimit	Shtirirja fizike madhësia	Kohëzgjatja	Ktheshmëria	Rëndësia e shtirirjes kohëzgjatja dhe ktheshmëria.	Nevojat për masat zbutëse.
TOKA					
Gjenerim dherash dhe masë inertesh.	Lokale	Përkohshëm	Po	I parëndësishëm	Nevojitet sistemimi i tyre.
Ndikim në gjenerim mbetjesh amballazh.	Lokale	Përhershme	Po	I parëndësishëm	Vendosja e koshave për grumbullimin e mbetjeve urbane në ambientet e objektit industrial
Zënia e një sipërfaqe toke nga ndërtimi i të gjithë objekteve	Me afat të përhershëm	70 vjet	Jo	I rëndësishëm	Shesh ndërtimi
BIODIVERSITET					
Shqetësim i faunës në zonë	Lokale	Përkohshëm	Po	I parëndësishëm	Duhet të kontrollohet se mos folezizon në zonën e objektit
Ujërat					
Shkarkim i i inerteve pa dashje në përrenj	Lokale	I përkohshëm	Jo	I rëndësishëm vetëm për momentin	Në vendet e caktuara nga Bashkia Elbasan
Shkarkimi i llumit nga gropa e dekantimit	Lokale	Ciklik	Po	I rëndësishëm për momentin	Shkarkimi në një gropë dekantimi para derdhjes në kanale
Ajër					
Zhurmat nga makineritë	Lokale	I përkohshëm	Po	I rëndësishëm pa	Zhurmat e tyre janë të standartizuara nga uzinat e prodhimit të makinerive
Shkarkimi i gazrave nga motorrat që punojnë me lëndë djegëse fosile.	Lokale	I përkohshëm	Po	I rëndësishëm pa	Të bëhet kontrolli i çlirimit të gazrave në skapamentot e makinerive.
Shkarkimi i nxehtësisë nga përcjellësit	Lokale	I përhershëm	Po	I rëndësishëm pa	Zgjedhja e përcjellësve me rezistencë përcjellshmëri elektrike sa më të vogël

Gjatë procesit të aktivitetit të “Fonderisë për Prodhimin e Materialeve të Gizës” do të ketë ndikime në:

Zona e banuar më e afërt. Zhurmat që do të krijohen nga makineritë janë mjaft të ulta, brenda normave të lejuara dhe nuk do të ndikojnë për keq nënjerëzit dhe habitatet e zonës. Objektindodhet në zonë industriale ekzistuese.

Habitatet. Habitatet në zonën industriale pothuajse nuk ekzistojnë.

Qendrat e banuara. Në qendrat e banuara ndërtimi i objektit industrial do të ndikojë për mirë në punësim gjatë aktivitetit të fonderisë në Njësinë Administrative Bradashesh.

Burimet ujore. Burimet nëntokësore ujore nuk preken. Furnizimi me ujë do të bëhet nga rrjeti ekzistues i linjës së furnizimit me ujë të pijshëm i Njësisë Administrative Bradashesh.

Zona arkeologjike. Nuk ka

Ndikimet pozitive në mjedisin e zonës së projektit

Për sa i përket ndikimeve pozitive në mjedisin e zonës, janë si më poshtë:

- Shfrytëzimi i lëndës së parë, skrapit të riciklueshëm dhe uji ku hyjnë si prodhime me lëndë të parë të rinovueshme
- **Përmirësim dhe ngritje të ekonomisë së zonës dhe atë personale të investitorit**
- Zhvillimi i ekonomisë dhe industrisë së rëndë, fonderisë, në Bashkinë Elbasan.

ë. Masat e mundëshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis në zbatimin e projektit

Ndikimet negative në mjedis japin dhe masat e mëposhtme:

Gjenerim dherash dhe masë inertesh. – Pas çdo procesi të prodhimit të gëzës dhe materialeve të derdhura nevojitet sistemimi dhe largimi i tyre.

Ndikim në gjenerim mbetjesh ambalazh. - Vendosja e koshave për grumbullimin e mbetjeve urbane dhe atyre të krijuara nga procesi i prodhimit të materialeve prej gize.

Zënia e një sipërfaqe toke - Gjelbërim i mundëshëm i territorit përreth objektit industrial.

Shqetësim i faunës në zonë - Nuk e shqetëson, procesi i prodhimit kryhet brenda në repart ditën, dhe në distancë nga zonat e faunës.

Shkarkimi i llumit nga baseni i dekantimit -Shkarkime në një gropë dekantimi para derdhjes nëkanalizimet e zonës.

Masa zbutëse për parandalimin e ndotjes dhe aksidenteve me pasoja negative në mjedis

Në mënyrë të përgjithshme do të japim disa prej masave që duhet të zbatohen nga investitori për mbarëfunksionimin e aktivitetit dhe ruajtjen e mjedisit fizik e biologjik.

- Gazrat mund të jenë të pranishëm në mjediset e punës, sidomos pranë furrave të shkrirjes së skrapit dhe prodhimit të gëzës, por edhe në zonën e derdhjes së kallëpeve prej gize. Si rrjedhojë subjekti duhet të kujdeset për një proces pune të kontrolluar të pandërprerë.
- Subjekti është përgjegjës që punonjësit, të cilët janë të riskuar nga këto fenomene, të përdorin maska kundër gazit, size për mbrojtjen nga ndriçimi dhe veshje të posaçme.

- Pajisjeve të punës, periodikisht, duhet t’u kryhen shërbimet e nevojshme, ndërsa pajisjeve nën presion (furrave të prodhimit duhet t’u kryhet inspektimi periodik, në mënyrë që të shmangen mundësitë e aksidenteve të derdhjes së gazës së shkrirë që ka pasoja në jetën e punonjësve që punojnë pranë furrave të shkrirjes.
- Të zbatohen kushte të larta sigurie fizike, të ketë roje të sigurisë fizike 24 orë në ditë. Të montohen postera sensibilizues në vende të caktuara, sidomos pranë furrave të gazës.
- Të mirëmbahen mjetet e mbrojtjes nga zjarri si hidrante dhe bombola kundër zjarrit. Këto të fundit të kontrollohen rregullisht nga ekspertët e zjarrfikses dhe të rinovohet çdo vit Akti-Teknik i mbrojtjes nga zjarri.
- Të mos hidhen mbetje në mjedisin e zonës, qofshin këto inerte apo lëndë e parë hekurishte. Ato të menaxhohen nga subjekti si lëndë e parë e riciklueshme.
- Subjekti të jetë në dijeni të gjithë kuadrit ligjor në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe zbatimit të kushteve teknike në mjediset e punës e të ndryshimeve që kryhen në këto të fundit

Sistemi i mbrojtjes ndaj zjarrit

Rreziku i rënies së zjarrit në Fonderinë e gazës dhe në produktin e gatshëm, duke vlerësuar vetitë fiziko-kimike të materialeve, është i vogël. Megjithatë është zbatuar një projekt i plotë i mbrojtjes nga zjarri, me mjete të mjaftueshme, përfshirë rrjetin e furnizimit me ujë dhe një depozitë uji në dispozicion, e përlogaritur për të përballuar të gjithë fluksin në rastet e rënies së zjarrit. Gjithashtu, në rast zjarri, është parashikuar plani për evakuimin e detyruar të njerëzve dhe mjeteve prej tyre. Ai është i detajuar dhe përbëhet nga fikse zjarri portative, rezervuar ujë, 2 fuçi me ujë dhe dy me rërë, rrufepritësa dhe rrjete tokëzimi, kosha metalike dhe tabelave sinjalizuese. Konsiderohen si pika tëmundshme të lindjes së zjarrit të gjithë objektet dhe ambjente të tjera shërbimi që përmbajnë materiale të djegëshme. Duke u nisur nga më sipër, shoqëria “ENIRA -METAL” shpk. duhet të mbajë parasysh statusin që ka zona ku është ngritur godina industriale. Për këtë ajoka marrë të gjitha masat parandaluese për rënien e zjarrit gjatë funksionimit të procesit të prodhimit dhe për ruajtjen e jetës së punonjësve që do të punojnë gjatë shfrytëzimit të Fonderisë së gazës.

Programi i monitorimit të ndikimeve në mjedis gjatë aktivitetit të prodhimit të SO₂

Qëllimet e monitorimit mjedisor

Monitorimi bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

Qëllimi i monitorimit mjedisor për aktivitetin e “Fonderisë për Prodhimin e Materialeve të Gizës” është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Objektivat e Monitorimit:

- Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit me atë gjatë funksionimit të instalimeve.

- Të monitorojë emetimet (nëse ka) në të gjitha fazat e zhvillimeve të projektit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë dhe BE.
- Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në rajonin ku ndodhet objekti ku janë instaluar linja e prodhimit të gizës dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me aktivitetin e propozuar.
- Për të përcaktuar efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga aktorët zhvillues të aktivitetit në rajon.
- Për të përcaktuar impaktet afatgjatë (nëse ka).
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajon, në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
- Të krijojë një arkivë (regjistër) të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.
- Për të garantuar përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar.

Kërkesa ligjore për kryerjen e monitorimit:

- Ligji nr. 10431 datë 09.06.2013 "Për mbrojtjen e mjedisit", kreu VI "monitorim i gjendjes së mjedisit";
- Subjekti është i detyruar të kryejë monitorimet periodike sipas kërkesave të përcaktuara në kushtet e lejes përkatëse mjedisore.

Plani i monitorimit

Me qenë se kemi të bëjmë me instalime të Fonderisë për Prodhimin e Materialeve të Gizës, i pozicionuar në territorin e ish Kombinatit Metalurgjik, Bradashesh, Elbasan nevojitet një monitorim i vazhdueshëm, jo vetëm në linjën e prodhimit dhe makineritë, por dhe në zonën për rreth linjës së prodhimit.

Plani i monitorimit do të konsistojë në :

- Monitorimine parametrave gjeometrike të impiantit të instaluar.
- Monitorimine zonës së mundëshme të gjenerimit të gazrave gjatë aktivitetit të prodhimit
- Monitorimine parametrave fizike dhe dinamike të shpërndarjes së emetimeve të gazeve dhe marrja e masave përkatëse të parashikuara në projekt, për parandalimin e tij.
- Monitorimine sjelljes së bimësisë ekzistuese në zonën përreth objektit dhe marrjen e masave për parandalimin e dëmtimit të tyre.
- Monitorimine shkarkimit të ujrave të ndotura urbane dhe industriale që gjenerohen nga aktiviteti i përditshëm i operimit të punës në objekt
- Monitorimine menaxhimit të mbetjeve të gjeneruara nga instalimet dhe mbetjeve nga aktiviteti i përditshëm human i punonjësve.
- Monitorimine sipërfaqeve të mbjella, pemëve dhe bimëve të kultivuara në zonë, ecurisë normale dhe zhvillimit të tyre

Objektivi i vetëmonitorimit të shkarkimeve në mjedis është të evidentojë vlerat reale të treguesve mjedisorë të gjendjes, ndikimit dhe trysnisë në ajër, në ujëra të brendshme, në tokë, me qëllim

që, në bazë të tyre, subjekti të ndërmarë masa dhe veprime korigjuese të përshtatëshme dhe të zbatueshme për zonën ku ushtron aktivitetin fonderia. Për rastet kur ka ndotje që ndikojnë në situatën e shëndetit publik dhe në mjedis, të përcaktojë shkallën e ndotjes dhe nivelin e devijimit nga normat e lejuara, në mënyrë që programi rehabilitues të hartohet i saktë dhe masat e ndërhyrjes të jenë ato të duhurat dhe në nivelin e duhur.

Në varësi të nivelit të zhvillimit të ndikimit mjedisor, masat që ndërmerren mund të përfshijnë ndalimin/eliminimin e shkakut të ndikimit, ose mund të jenë të karakterit zbutës e reduktues.

Zgjidhja më e mirë, kur rrethanat e lejojnë, është ndalimi/eliminimi i ndotjes dhe shkaqeve të tjera. Në përgatitjen e programit të monitorimit specialistët kanë marrë në konsideratë mundësinë për të realizuar një monitorim realist të elementeve me ndikim në mjedis. Subjekti merr përsipër sigurimin e ecurisë normale të punës dhe ruajtjen e vazhdueshme të mjedisit deri në mbylljen e aktivitetit. Ai gjithashtu, do të ketë lidhje të vazhdueshme me Agjensinë Rajonale të Mjedisit Elbasan, pranë të cilës do të informojë periodikisht për mbarvajtjen e punës si gjatë prodhimit të fonderisë së gizës ashtu dhe për monitorimin e parametrave të mësipër.

Masat për rigjenerimin e mjedisit

Masat për rigjenerimin hap pas hapi, krahas “Prodhimit të Materialeve të Gizës” konsistojnë në:

1. Krijimin e sipërfaqeve për mbjellje me bimësi
2. Mbjelljen e sipërfaqeve të reja me fidanë pishë dhe barishte të ndryshme
3. Mirmbajtjen e sipërfaqeve të mbjella
4. Kapja dhe trajtimi i gazeve që gjenerohen nga instalimet për prodhimin e bioksidit të squfurit

MONITORIMI DHE REKOMANDIME

Monitorim është procesi i zbulimit të ndryshimeve nëse do të ndodhin, përcaktimit të drejtimit dhe i matjes së shtrirjes së tyre. Procesi i monitorimit do të përqëndrohet në të gjithë fazat e zhvillimit të aktivitetit prodhues të fonderisë së gizës dhe fokusohet në aktivitetet që gjenerojnë ndikime negative në mjedis, në efektet e këtyre ndikimeve dhe në zbatimin e masave për zbutjen e tyre. Monitorimi do të kryhet nga vetë investori dhe në rast të pamundësisë teknike për realizimin e tyre do të kërkohet bashkëpunim i subjekteve të specializuara për fushat përkatëse. Verifikimi i monitorimit apo auditimit do të organizohet nga institucionet administrative si AKM-ja, ISHMP dhe Ministria e Mjedisit etj.

Tabela Nr. 43 PLANI I MONITORIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS.

Emërtimi	Masa	Përgjegjësia	Shënime
Shkarkime në ajër nga furra e shkrires sëskrapit të gizës	Të monitorohen shkarkime në ajër nga furra e shkrires sëskrapit të gizës	shoqëria “ENIRA - METAL” sha.	Frekuenca dhe metodika në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar për mjedisin dhe udhëzimet e institucioneve të huaja botërore për këtë qëllim Të raportohet menjëherë në rast shmangie nga kufijtë ligjorë dhe praktika më e mirë.

Mbetje	Monitorimi i sasisë së mbetjeve të gjeneruara nga instalimet dhe plani i menaxhimit të mbetjeve	shoqëria “ENIRA - METAL” sha.	Të dhënat e monitorimit dhe gjendja e përputhjes së tyre me këtë Plan Monitorimi në Mjedis do të raportohen.
Ujërat e përdorura në procesin e ftohjes	Monitorimi i sasisë së ujrave të përdorura në procesin e ftohjes së instalimeve	shoqëria “ENIRA - METAL” shpk	Shpeshtësia dhe metodikat do të përmbushnin kërkesat e legjislacionit shqiptar të mjedisit

Indikatorët e mësipërm të monitorimit janë një ndërthurje treguesish me të cilët vlerësohet shumë objektivisht trysnia që ushtron zbatimi i këtij projekti në mjedis, si dhe gjendja e mjedisit, ndikimit të funksionimit të projektit të zbatuar në këtë gjendje. Matja dhe mbledhja e të dhënave për treguesit e mësipërm është bërë konform metodave dhe teknikave shkencore të njohura dhe të pranueshme. Të dhënat që do të mblidhen do të vihen në dispozicion të organeve shtetërore dhe të interesuarve të tjerë, gjithashtu këto të dhëna do të analizohen me qëllim përmirësimin e performancës mjedisore të veprimtarisë dhe bërjen e korigjimeve të nevojshme.

Monitorimi është detyrë e shoqërisë investitore në nivel individual për pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 të Vendimit Nr.1189. datë 18.11.2009 “Për monitorimet në Republikën e Shqipërisë”

Regjistimi i të dhënave mjedisore. Për të ruajtur të dhënat mjedisore të veprimtarisë do të përgatitet dhe mbahet një regjistër i veçantë ku do të pasqyrohen të gjitha parametrat e monitoruar nga shoqëria “ENIRA - METAL” shpk. mirëmbajtja dhe përditësimin e regjistrit nga drejtuesi teknik i instalimit.

f. Ndikimet e mundëshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë)

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhojë edhe ndikimi i tij nuk shkakton dëmtim të mjedisit ndërkufitar. Për këtë kapitull, nuk kryhen vlerësime dhe analiza të detajuara për shkak të vendodhjes së projektit në brendësi të kufirit shtetëror dhe distancës që ai ruan me kufirin dhe shtetet fqinje.

Rekomandime: Në vijueshmëri të zbatimit të masave konform kërkesave të kohës mendojmë:

- Të ketë ambiente pune sa më të pastra për eliminimin e ndotjes
- Të mbahen në kontroll të rreptë çlirimet e gazrave në ajër nga furrat e gizës
- Të bëhet kontrolli teknik i furrave të shkrirjes
- Të zbatohen të gjitha masat e sigurimit teknik për ruajtjen e jetës së punonjësve
- Të punohet me kujdes për ruajtjen e gjelbërimit publik ekzistues dhe atij privat të ambientit ku do të kryhen proceset teknologjike.

Konkluzione

Nga verifikimi i mjedisit ku do të realizohet aktiviteti “Fonderisë për Prodhimin e Materialeve të Gizës” dhe të dhënave që pasqyrohen në Raportin e VNM-së të veprimtarisë së mësipërme, rezulton se ushtrimi i këtij aktiviteti, bëhet konform të gjithave rregullave të përcaktuara. Ndikimi në mjedis është parashikuar dhe vlerësuar me objektivizëm në sipërfaqen që do të

përdoret për kryerjen e aktivitetit prodhues dhe përdorimit të teknologjisë së prodhimit të materialeve prej gize. Bashkia Elbasan së bashku me ARM duhet të kontrollojë të gjithë proceset dhe monitorimet që do të kryejë investitori për aktivitetin prodhues

Ndikimi në mjedisin e zonës gjatë aktivitetit të “Fonderisë për Prodhimin e Materialeve të Gizës”, është një ndikim që kërkon vëmendje dhe duhet monitoruar në çdo kohë, dhe shoqëria “ENIRA - METAL” shpk. së bashku me organet e qeverisjes vendore, do të punojnë që ky ndikim të mbetet minimal, nën normat e kërkuara, gjatë funksionimit të objektit industrial.

Pas përfundimit të projektit të zbatimit, si eksperte mjedisi me kërkesë të investitorit hartova: Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për aktivitetin e **“Fonderisë për Prodhimin e Materialeve të Gizës, Njësia Administrative Bradashesh, Bashkia Elbasan**

Eksperte mjedisore

Ing. Lila Karaj